

KONTRATË SHIT-BLERJE **KUOTASH**

Sot, në datë 13 / 10 /2023, në selinë e shoqërisë “**MODESTE**” sh.p.k. në Fier me NUIS J62903413B, adresë: Lagjia 1 Maj, Fier palët e mëposhtme, kanë hartuar dhe dakortësuar këtë kontrate shit-blerje kuotash me termat e mëposhtme:

SHITËSI: z.Xhentil **Kotobelli**, atësia Skënder, amësia Dareko, shtetas Shqiptar, lindur në Prishtë, Skrapar dhe banues në Rr. Ibrahim Rugova, Tiranë, lindur më 28/04/1960, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit garantohemi me Passaport nr. personal G00428048U, për efekt të kësaj kontrate do të quhet *Shitësi*.

DHËNËSE PËLQIMI : znj. **Mimoza Kotobelli** atësia Skënder, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Rr. Ibrahim Rugova, Tiranë, lindur më 01/04/1962, gjendja civile “e martuar”, madhare, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës garantohemi me ID nr. 025863733 dhe nr. personal G25401098B, për efekt të kësaj kontrate do të quhet *Shitësi*.

BLERËSI : z. **Refit Hyseni**, atësia Jakup, amësia Hajruka, shtetas shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë me adresë Rr. Grigor Heba, Nd 27, H.1, Njësia Administrative Nr.5, lindur më 17/05/1957, gjendja civile “i martuar”, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me leternjoftimin ID nr. 033422934 dhe nr. Personal F70517020L, për efekt të kësaj kontrate do të quhet *Blerësi*.

Palët lidhin mes tyre këtë kontratë: Në zbatim të nenit 73, 74 dhe 75 e vijues të ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, dhe Statutit të shoqërisë “**MODESTE**” sh.p.k, të detyrueshme për shoqëritë tregtare, me kushtet dhe termat e mëposhtme:

Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja e 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotës që shitësi zoteron në kapitalin themeltar, e cila përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë ose më saktë përfaqësuesi i 3850 kuota (tremijë e tetëqind e pesëdhjetë kuotave) Kjo kuotë transferohet nga Shitësi në pronësi të Blerësit.
- 1.2 Blerësi pranon pronësinë e kuotave duke pranuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi.

Neni 2 Cmimi i Shitjes

2.1 Cmimi për blerjen e kuotës do të jetë kundrejt vlerës së saj nominale, në total i barabartë me 3.850.000 lekë (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë lekë). Kjo shumë është likuidar totalisht në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe palët nuk kanë detyrime të pashlyera ndaj njëri – tjetrit.

Neni 3 Të drejtat dhe detyrimet e palëve

3.1 Shitësi garanton se kuota objekt i kësaj kontrate është e transferueshme dhe se ai është i vetmi pronar e gjëzon të drejta të plota mbi kuotën.

3.2 Shitësi pranon se cmimi i cituar në nenin 2 të kësaj kontrate është cmimi i vetëm dhe përfundimtar në lidhje me shitjen e kuotës që ai kishte në shoqërinë “Modeste” shpk, dhe se për këtë qëllim nuk ka asnjë pretendim vijues të cdo lloj natyre.

3.3 Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate, shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën objekt të kësaj kontrate, kuotë që menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate i kalon blerësit, ashtu si cdo e drejtë apo përfitim tjetër i lidhur me të.

3.4 Blerësi paguan cmimin e shitjes sipas përcaktimit të bërë në nenin 2 të kësaj kontrate.

3.5 Blerësi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë sipas legjislacionit në fuqi nga titulli i pronësisë mbi këto kuota nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Blerësi bëhet zotërues me të drejta të plota i këtyre 50 % (pesëdhjetë përqind) të kuotave në shoqërinë “Modeste” shpk.

Neni 4 Juridiksioni

4.1 Për cdo mosëmarrveshje lindur mes Palëve lidhur me interpretimin, zbatimin e kontratës e cila nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, juridiksioni kompeten do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Neni 5 Dispozita të fundit

5.1 Nenet e përgjithshme janë pjesë e panadarë e kësaj kontrate.

5.2 Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga palët.


5.3 Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve, duke respektuar formën shkresore të saj.

Kjo kontratë hartohet në 3 kopje me vlerë të barabartë ligjore, në gjuhën shqipe. Palët deklarojnë se e njohin dhe e kuptojnë përmbajtjen e kësaj kontrate, si dhe u pranua nga ata sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë. Ajo u nënshkrua në mënyre të rregullt nga palët.

PALËT

SHITËSI

z. Xhentil KOTOBELLI



Dhënëse Pëlqimi

znj. Mimoza KOTOBELLI



BLERËSI

z. Refit HYSENI

